

VENDIM
Nr.1083, datë 28.10.2009

PËR NGRITJEN E QENDRËS SË MBYLLUR DHE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIT TË SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 83 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe miratimin e rregullores së organizimit e të funksionit të saj, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e akteve të nevojshme në zbatim të rregullores.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË MBYLLUR

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Krijimi i Qendrës së Mbyllur dhe statusi i saj

1. Në zbatim të nenit 83 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, ngrihet Qendra e Mbyllur për të huajt e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme.

3. Rregullorja e brendshme e Qendrës miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 2

Objekti i rregullores

1. Kjo rregullore përcakton ngritjen, organizimin dhe funksionimin në Qendrën e Mbyllur, përgjegjësitë e punonjësve të Qendrës së mbyllur, rregullon regjimin e mbajtjes së të huajve të parregullt të strehuar në Qendër në pritje të ekzekutimit të urdhrit të largimit me forcë, urdhrit të dëbimit apo të ripranimit, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, asistimin e tyre nga ana psiko-sociale, përgatitjen e largimit të tyre nga territori, si dhe nxitjen e tyre të respektojnë vendimet për largim nga territori.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore është e detyrueshme të zbatohet vetëm në Qendrën e Mbyllur.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet në qendrën e pritjes së azilkërkimit, në qendrën e rehabilitimit të viktimave të trafikimit apo në institucionet e paraburgimit ose vuajtjes së dënimit.

3. Ndalimi dhe mbajtja në Qendër e të huajt të parregullt nuk përbëjnë sanksione, por janë mjete për zbatimin e një mase largimi.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Aktivitet: veprimtari që zhvillohet në dobi të shtetasve të huaj të ndaluar me qëllim kulturor sportiv, argëtues etj.
2. Autoriteti shtetëror përgjegjës për kontrollin e të huajve në territor: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, si dhe çdo strukturë tjetër në varësi të tij, të cilët ushtrojnë funksione në fushën e legjislacionit për të huajt, sipas kompetencave që u njeh ligji nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. Autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit: Zëvendësrejtori i Përgjithshëm i Policisë për Kufirin dhe Migracionin.
4. Autoriteti epror: Drejtori i Migracionit dhe Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
5. Drejtori i Përgjithshëm: Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
6. I huaj i ndaluar: I huaji i gjendur me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë, i cili, në zbatim të një masë administrative dhe në përputhje me nenin 82 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” qëndron i ndaluar në Qendrën e Mbyllur.
7. Largim nga territori: largimi i një të huaji nga territori i Republikës së Shqipërisë në përmbushje të dispozitave të parashikuara në ligjin nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.
8. Ministri: Ministri i Brendshëm.
9. Qendra e Mbyllur: Qendra e Ndalimit të të Huajve të Parregullt, në vartësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme.
10. Zëvendësues: personi të cilit i delegohet përgjegjësia e drejtimit të Qendrës në mungesë të shefit të Qendrës.

Neni 5
Subjektet e ndalimit në Qendër

Subjekt i ndalimit në Qendrën e Mbyllur janë të huajt sipas parashikimeve të nenit 80 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”.

PJESA E DYTË
ORGANIZIMI I BRENDSHËM NË QENDËR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. I huaji i ndaluar në Qendër ka të drejtë, në zbatim të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, të përfitojë asistencë individuale mjekësore, ligjore dhe sociale.
2. I huaji i ndaluar duhet të respektojë mendimin dhe specifikat e të tjerëve në fushën fetare, filozofike, kulturore dhe politike.

Neni 2

Çdo i huaj i ndaluar trajtohet nga personeli i Qendrës në mënyrë të barabartë, korrekte, të respektueshme dhe pa asnjë diskriminim, duke respektuar jetën e tij private.

Neni 3

Personeli i Qendrës merr kontakte me të huajt e ndaluar vetëm në ushtrim të detyrës së tij gjatë shërbimit.

Neni 4

1. Çdo i huaj i ndaluar në Qendër duhet të njihet me të drejtat dhe detyrimet e tij që burojnë nga ligji, kjo rregullore dhe rregullorja e brendshme e Qendrës. Për këtë qëllim nga biblioteka e institucionit i vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore.

2. Për të huajt e ndaluar në Qendër që nuk dinë shkrim e këndim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga shërbimi i edukimit.

3. Të huajt e ndaluar në Qendër që nuk dinë gjuhën shqipe ose gjuhën angleze, iu vihen në dispozicion këto akte në një gjuhë që ai e kupton, për aq sa është e arsyeshme dhe e mundshme praktikisht.

KREU II

PRANIMI DHE AKOMODIMI NË QENDËR

Neni 1

Pranimi i të huajit

1. Pranimi i të huajit në Qendër bëhet mbi bazën e urdhrat të ndalimit në Qendrën e Mbyllur të nxjerrë nga autoriteti rajonal për kufirin dhe migracionin.

2. I huaji i cili kërkohet të ndalohet, duhet të jetë i shoqëruar me dosjen e tij personale, e cila duhet të përmbajë:

a) Procesverbalin e përzgjedhjes;

b) Urdhrin e largimit me forcë ose të dëbimit, si dhe urdhrin e largimit, nëse më parë është nxjerrë një i tillë;

c) Dokumentacioni i dhënies dhe marrjes në dorëzim së bashku me sendet personale të gjetura në momentin e ndalimit nga shërbimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit apo marrjes në dorëzim të tij nga autoritetet e vendeve të tjera gjatë procedurës së ripranimit;

d) Informacion i shkurtër (fillestar) lidhur me situatën psiko-fizike (probleme shëndetësore/ i dhunshëm ose jo) të vërejtur që nga momenti i ndalimit.

e) Një informacion i shkurtër lidhur me situatën në të cilën është kapur i huaji ose arsyen e ripranimit në Shqipëri të plotësuar nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Neni 2

Kontrolli fizik dhe regjistrimi në Qendër

1. Me paraqitjen e shërbimit të autoriteteve rajonale ose lokale për kufirin dhe migracionin me të huajin subjekt ndalimi në Qendër, punonjësi i ngarkuar me pritjen dhe regjistrimin në Qendër, verifikon saktësinë e dokumentacionit dhe identitetin e të huajit/ve subjekt ndalimi në Qendër.

2. Në rast se mungon urdhri i ndalimit në Qendër të Mbyllur, institucioni i Qendrës së Mbyllur nuk e pranon të huajin dhe njofton për këtë autoritetin epror.

3. Në rast se mungojnë dokumentet e parashikuara në pikat e tjera të nenit 8 dhe çmohet se mospranimi ka pasoja ose shkelen të drejtat e të huajit, i huaji pranohet në Qendër, njoftohet menjëherë autoriteti epror dhe në bashkëpunim me autoritetin rajonal për kufirin dhe migracionin brenda 3 ditëve plotësohet dokumentacioni i kërkuar.

4. Kur identiteti dhe dokumentacioni është i rregullt, përpilohet procesverbali i marrjes në dorëzim të të huajit, dokumenteve shoqëruese dhe sendeve personale të tij. Në procesverbal shënohet data dhe ora e pranimit.

5. Në ato raste kur lindin dyshime dhe dokumentet shoqëruese përmbajnë edhe gjurmët e gishtërinjve, bëhet verifikimi i tyre me gjurmët e marra në momentin e pranimit. Ky verifikim bëhet nga shërbimi kriminalistik i Policisë së Shtetit të vendit të Qendrës së Mbyllur, duke u depozituar akti në dosjen personale.

6. Kur nga verifikimi i mësipërm rezulton mospërputhje, njoftohet menjëherë autoriteti epror.

7. Shtetasi i huaj i ndaluar bëhet objekt i një kontrolli të imët trupor, i cili kryet nga personeli i sigurisë së Qendrës. Personeli i sigurisë kryen gjithashtu kontrollin e veshjeve dhe bagazheve të tij.

8. Kontrolli kryet nga një anëtar i personelit të sigurisë, i cili duhet t'i përkasë të njëjtit seks sikundër shtetasi/ja i/e huaj ose një anëtar tjetër i personelit të të njëjtit seks, i cili e kryen atë nën mbikëqyrjen e përgjegjësit të shërbimit.

9. Për kontrollin e objekteve metalike përdoren detektorët për metale.

10. Ky kontroll ka për qëllim të verifikojë nëse shtetasi i huaj i ndaluar zotëron objekte apo materiale të ndaluara apo potencialisht të rrezikshme për veten, për të tjerët, për personelin apo për sigurinë e Qendrës.

11. Kontrolli nuk mund ta kalojë kohën e nevojshme për kryerjen e tij dhe kryhet me urdhër të shefit të Qendrës apo zëvendësuesit të tij.

12. Pas kontrollit të sigurisë, shtetasi i huaj i ndaluar duhet të përdorë pajisjet sanitare, përveç se kur për arsye mjekësore apo sigurie, ato nuk këshillohen.

13. Shtetasi i huaj i ndaluar ftohet të bashkëpunojë për realizimin e kësaj procedure.

Neni 3

Sendet personale dhe ruajtja e tyre

1. Të ndaluarve u lejohet të mbajnë me shpenzimet e veta:

a) një unazë rreth;

b) orë dore;

c) radio të vogël me kufje;

d) libra, revista, gazeta e botime të ndryshme;

e) lojëra tavolinë, si shah, domino etj;

f) objekte të tjera për përdorim personal me leje të drejtorit të institucionit.

2. Objektet e rrezikshme dhe të ndaluara duhet të ruhen në kasaforta të sigurta (vende të siguruara), ashtu si dhe objektet me vlerë.

3. Këto vende të siguruara (kasaforta) duhet të jenë nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e shefit të Qendrës.

4. Në qendër krijohet një regjistër/inventar i të mirave materiale, të cilat sigurohen në një vend të sigurt (kasafortë). Shtetasi i huaj i ndaluar merr një kopje të listës inventarit nënshkruar nga vetë ai dhe nga dy anëtarë të personelit të caktuar për këtë qëllim.

5. Sendet personale dhe vlerat monetare të të huajit të ndaluar i jepen atij në momentin largimit të tij nga Qendra ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga të afërmit e tij sipas autorizimit të lëshuar nga i huaji i ndaluar kundrejt procesverbalit të firmosur nga marrësi dhe nëpunësi i institucionit.

Neni 4

Mjetet monetare

1. Të ndaluarit në Qendër lejohen të mbajnë mjete monetare vetëm në formë depozite në arkën e Qendrës së Mbyllur. Në rregulloren e brendshme të Qendrës përcaktohet mënyra e depozitimit të të hollave të tyre jashtë Qendrës.

2. Të ndaluarit në Qendër mund të disponojnë e përdorin shumën e parave që kanë depozituar me anën e një urdhri pagese për çdo blerje të sendeve, të cilat lejohen nga rregullorja e brendshme e Qendrës. Ata kanë të drejtë t'i dërgojnë mjete monetare familjes, në përputhje me rregulloren e brendshme të Qendrës.

Neni 5

Kontrolli mjekësor

1. I huaji i ndaluar duhet të bashkëpunojë për kontrollin mjekësor. Ky kontroll kryet i detyrueshëm me pranimin në Qendër dhe periodik pas ndalimit në Qendrën e mbyllur sipas një plani të vizitave të miratuar nga drejtori i Qendrës.

2. Mjeku i Qendrës ose mjeku i kontraktuar me Qendrën informohet për gjendjen shëndetësore dhe nevojat mjekësore të të huajit të ndaluar dhe kujdeset, nëse është e nevojshme, për një trajtim të përshtatshëm.

Neni 6

Regjistri i të ndaluarve

1. Mbi bazën e procesverbaleve të pranimit, në Qendër mbahet një regjistër, në të cilin pasqyrohen të dhënat themelore të të ndaluarve si vijon:

a) Informacion i plotë në lidhje me identitetin e të ndaluarit (emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, adresa në momentin e konstatimit me qëndrim të parregullt në territor, të afërmit me të cilët mund të komunikojë).

b) Arsytet e ndalimit dhe autoriteti përkatës që ka dhënë urdhrin e ndalimit, vendimin, afatin e ndalimit, si dhe afatet e shtyrjes së ndalimeve.

c) Data dhe ora e pranimit në Qendër, si dhe e largimit nga Qendra. Në rast vdekjeje të të ndaluarit, pasqyrohet në regjistër data, vendi dhe ora e vdekjes, shkaku i vdekjes, kopje e aktit të vdekjes dhe kujt iu dorëzua kufoma.

Neni 7

Akomodimi në Qendër

1. Në shpërndarjen e të ndaluarve në dhoma në Qendër do të mbahen parasysh krijimi i lehtësirave për trajtimin dhe përshtatjen e tyre shoqërore deri në largimin e tyre.

2. Në vendosjen e të ndaluarve nëpër dhoma duhet të mbahen parasysh disa kritere që lidhen me kombësinë e tyre, moshën, gjendjen shëndetësore dhe nevojat mjekësore, arsimi, veçoritë intelektuale dhe psikike, besimin fetar, kërkesat e veçanta për trajtimin e tyre, problemet konfliktuale etj.

3. Ndalohet mbajtja e të ndaluarve të mitur në një dhomë me të rriturit ose vendosja e të miturave vajza me të mitur djem në një dhomë. Të ndaluarit e mitur vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke iu krijuar mundësi për një trajtim të veçantë. Të miturat vajza mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e vetëm të një personeli femëror.

4. Gratë e ndaluara vendosen në dhoma dhe seksione të veçuara nga burrat dhe gëzojnë trajtim të veçantë, me personel femëror.

5. Familjet e ndaluara vendosen në seksione të veçanta dhe në ambiente të përbashkëta.

Neni 8

Dhomat dhe pajisjet e tyre

1. Në strehimin e të ndaluarve në Qendër duhet të garantohet në çdo rast kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo me pak se 4 m² për çdo të ndaluar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e jetuar në Qendër.

2. Drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike. Të ndaluarve u sigurohet në vazhdimësi energji elektrike e nevojshme për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale.

3. Dritaret të jenë në pjesën e sipërme të murit të jashtëm, me xham me përbërje rrjetë teli, të përforcuara nga jashtë me hekura të trasha.

4. Dhomat mbyllen nga dyer hekuri me çelës. Në pjesën e sipërme dyert duhet të kenë një dritare me madhësi të tilla që ta lejojnë punonjësën e institucionit të shohë brenda në dhome, me qepen të lëvizshëm nga ana e jashtme.

5. Në dhomë duhet të ketë detyrimisht, për çdo të ndaluar, një raft, një krevat hekuri të fiksuar fort me dyshtet ose me muret (lejohen krevate tip “marinar”), një tavolinë e karrige të fiksuara në dyshtet ose plastike.

6. Çdo dhomë duhet të jetë e kompletuar me WC të përshtatshme për nevoja personale të të ndaluarve duke garantuar privatësinë.

7. Drejtori i Qendrës, në vartësi të personalitetit të të ndaluarit ose të të dhënave kriminale të tij, mund të kufizojë mbajtjen e sendeve dhe objekteve të veçanta të dhomës ose ato personale, të cilat mund të favorizojnë dhunën kundër të tjerëve ose vetvetes në Qendër.

Neni 9

Veshjet dhe pajisjet e fjetjes

1. Çdo të ndaluar i sigurohen shtresat dhe mbulesat për fjetje në përputhje me kushtet klimaterike si: një dyshek, një jastëk, dy çarçafë, një këllëf jastëku, një batanije për stinën e verës plus tre batanije për dimër.

2. Çdo të ndaluar duhet t’i lejohet veshje e përshtatshme sipas klimës, në sasi të mjaftueshme, në

gjendje të mirë e të pastra.

Neni 10

Numri identifikues i të ndaluarit

Të ndaluarit, që në momentin e pranimit, i caktohet një numër identifikues, i cili regjistrohet në regjistrin themelor të Qendrës.

Neni 11

Shfrytëzimi i të dhënave

1. Raportet dhe informacioni lidhur me të ndaluarit duhet të mbahet duke pasur parasysh karakterin konfidencial dhe mund të shihet vetëm nga personat e autorizuar.

2. Të dhënat që ndodhen në regjister dhe në dosje regjistrohen në Regjistrin Kombëtar për të Huajt vetëm për rubrikat e posaçme të regjistrit.

3. I huaji i ndaluar mund t'i konsultojë këto dokumente dhe nëse konstatohet që këto dokumente janë false ose të falsifikuara, mund të ruajë një kopje të tyre, me kërkesë të tij.

4. Në rast se informacioni kërkohet nga një i tretë, për dhënien e tij duhet marrë më parë pëlqimi i të ndaluarit.

5. I huaji i ndaluar i nënshtrohet marrjes së gjurmëve të gishtave dhe marrjes së fotografisë në përputhje me nenin 76 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".

Neni 12

Ajrimi

1. Çdo i ndaluar ka të drejtë të shëtisë minimalisht 2(dy) orë në ditë në mjediset e jashtme të Qendrës.

2. Për arsye mjekësore apo në interes të të ndaluarit, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të vendosë ndryshe.

3. Kohëzgjatja e shëtitjes për arsye sigurie mund të kufizohet, por huaji i ndaluar duhet gjithmonë të ketë mundësinë të shëtisë një orë në ditë.

4. Kur një i huaj i ndaluar, me sjelljen e tij vë në rrezik sigurinë e tij, sigurinë të ndaluarve të tjerë, të anëtareve të personelit apo të Qendrës, apo kërcënon mirëfunksionimin e saj, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të bëjnë përjashtim.

5. Dalja në ajrim bëhet me grupe ose individualisht. Në dalje dhe në hyrje bëhet kontrolli fizik i të ndaluarve. Gjatë kohës që kryhet ajrimi, vëzhgohen veprimet e të ndaluarve në ajrim.

Neni 13

Fjetja

1. Koha e pushimit (fjetjes) e të ndaluarve bëhet duke respektuar orarin e veprimeve, të miratuar nga drejtori i Qendrës. Kjo kohë mund të ndryshojë sipas stinës dhe grupeve të të ndaluarve, si mosha, seksi.

Neni 14

Informimi i të huajt të ndaluar

1. Kjo rregullore duhet të jetë vazhdimisht në dispozicion të çdo personi që dëshiron ta konsultojë atë gjatë kohës së qëndrimit në Qendër.

2. Çdo të huaji të ndaluar i jepet një broshurë (fletëpalosje) e cila përmban të drejtat dhe detyrat që lidhen me qëndrimin e tij në Qendër dhe mundësia e një asistence në fushat mjekësore, ligjore, psiko-sociale, morale, filozofike, fetare etj. Çdo i huaj i ndaluar merr një broshurë informimi, e cila i shpjegon mundësitë e apelimit kundër ndalimit në Qendër, mundësitë e ankimit në lidhje me rrethanat e ndalimit, mundësitë e përfitimit të asistencës nga një organizatë jofitimprurëse, si dhe të kërkojë asistencë juridike. Këto dy broshura duhet të jenë të përkthyer minimalisht në gjuhën angleze.

3. Drejtori i Qendrës, zëvendësuesi i tij apo një anëtar i personelit i caktuar prej tij, i shpjegon të

huajit arsyet e ndalimit të tij, dispozitat ligjore dhe rregullat të cilave ai duhet t'u nënshtrohet, si dhe rrugët ligjore të parashikuara për të apeluar kundër ndalimit. Shpjegimi bëhet në gjuhën që kuptohet nga i huaji i ndaluar. Nëse është e nevojshme, për këtë thirret një përkthyes.

PJESA E TRETË RREGULLAT GJATË QËNDRIMIT NË QENDËR

KREU I SHKËMBIMI I KORRESPONDENCËS

Neni 1

1. Me shkëmbim korrespondence kuptohet çdo formë poste që hyn apo del nga Qendra.

Neni 2

1. I huaji i ndaluar ka të drejtë të shkëmbejë korrespondencë çdo ditë dhe në mënyrë të pakufizuar, përveç se kur bie ndesh me dispozitat e nenit 4, kreu I, pjesa e tretë, të kësaj rregulloreje.

Neni 3

1. Në çdo moment mbërritjet postare kontrollohen me qëllim për të përcaktuar nëse ato nuk përmbajnë objekte të tjera përveç letrave. Ky kontroll kryet në prani të marrësit të letrës. Objektet e rrezikshme apo të ndaluara vendosen në vende të sigurta.
2. Përveç rasteve të parashikuara në nenin 4, kreu I, pjesa e tretë, të kësaj rregulloreje, personeli i Qendrës nuk mund të njihet me përmbajtjen e letrave.

Neni 4

1. Kur ekzistojnë tregues seriozë se një shkëmbim korrespondence përbën rrezik për sigurinë kombëtare, sigurinë publike apo rendin publik ose në marrjen e masave parandaluese kundër kryerjes së veprave penale, mbrojtja e shëndetit, e të drejtave dhe lirive individuale ose mbrojtja e sigurisë së Qendrës gjykohen të domosdoshme, korrespondenca që i huaji dëshirojnë të dërgojnë apo marrin, mund t'i nënshtrohet një kontrolli të përmbajtjes së saj nga drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij para dërgimit apo shpërndarjes së saj. Ky kontroll kryet në prani të të huajit të interesuar.
2. Nëse rezulton se përmbajtja e korrespondencës përbën një rrezik serioz për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, rendin publik apo kur kërkohet marrja e masave parandaluese kundër kryerjes së veprave penale, mbrojtja e shëndetit, e të drejtave dhe lirive individuale apo mbrojtja e sigurisë së Qendrës, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të vendosë të mos dërgojë apo dorëzojë korrespondencën. Ai duhet të njoftojë menjëherë për këtë autoritetin epror shtetëror përgjegjës.

Neni 5

1. Një anëtar i personelit i caktuar nga drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij asiston të huajt e ndaluar që nuk disponojnë njohuri të mjaftueshme në hartimin dhe leximin e korrespondencës postare të tyre, nëse kjo kërkohet nga ata.

Neni 6

1. Qendra u ofron falas të huajve të ndaluar letër shkrimi. Nëse ata nuk janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet e postimit të korrespondencës, Qendra, në kufijtë e një shume të arsyeshme, mund t'i mbulojë shpenzimet e postimit.
2. Korrespondenca duhet të hidhet në kutinë postare të Qendrës. Letrat merren nga një punonjës i Qendrës dy herë në javë dhe postohen sipas destinacionit. Shpërndarja e korrespondencës së ardhur bëhet nga ky punonjës, duke ruajtur intimitetin dhe fshehtësinë e saj.
3. Korrespondenca e të ndaluarve me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.

KREU II PËRDORIMI I TELEFONIT

Neni 1

1. Çdo i huaj, në momentin e ndalimit në Qendër, ka të drejtë për të kryer një thirrje telefonike falas brenda vendit të paktën për një kohëzgjatje prej 5 minutash.

2. I huaji i ndaluar ka të drejtë të telefonojë, vetëm nëpërmjet aparatit kartofonik, me shpenzimet e tij midis orës 08.00 të paradites deri në orën 20.00 të mbrëmjes. Drejtori i Qendrës në çdo kohë sigurohet që të gjithë të huajt e ndaluar mund ta gëzojnë realisht këtë të drejtë në të njëjtën mënyrë. Gjate bisedave telefonike, anëtarët e personelit të mbikëqyrjes respektojnë karakterin privat të tyre.

Neni 2

1. Në interes të sigurisë kombëtare, të sigurisë publike, të mbrojtjes së rendit publik ose në rastin kur kërkohet marrja e masave parandaluese kundër kryerjes së veprave penale, mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive individuale ose mbrojtja e sigurisë së Qendrës, drejtori i Qendrës ose zëvendësuesi i tij mund të ndalojë kontaktin telefonik. Ai duhet të njoftojë menjëherë autoritetin epror shtetëror përgjegjës.

PJESA E KATËRT VIZITAT

KREU I VIZITORËT

Neni 1

Vizitorët duhet të jenë mbajtës të një dokumenti identiteti të vlefshëm, për ta paraqitur pranë autoriteteve të Qendrës në fillim të vizitës.

Neni 2

1. Vizitorët bëhen objekt i një kontrolli të imët, i cili kryhet nga personeli i sigurisë së Qendrës. Ky kontroll përfshin kontrollin trupor dhe të veshjeve të vizitorët, si dhe kontrollin e objekteve që ata disponojnë.

2. Kontrolli kryet nga një anëtar i personelit të sigurisë të të njëjtit seks me vizitorin ose nën mbikëqyrjen e përgjegjësit të shërbimit, nga një anëtar tjetër personeli i të njëjtit seks. Kontrolli i vizitorit kryhet gjithmonë para takimit të vizitorit me të ndaluarin.

3. Objektet metalike kontrollohen me anën e një detektori metalesh.

4. Kontrolli i vizitorit ka për qëllim të kontrollojë nëse vizitori zotëron objekte apo materiale prej metali ose potencialisht të rrezikshme për vetë atë, për të huajt e ndaluar, për personelin apo për sigurinë e Qendrës.

5. Kontrolli nuk duhet ta tejkalojë kohëzgjatjen e nevojshme gjatë ekzekutimit dhe kryet me urdhër të drejtorit të Qendrës apo zëvendësuesit të tij.

6. Vizitori ftohet të bashkëpunojë për realizimin e kësaj procedure.

7. I huaji i ndaluar që ka pritur një vizitë, pas mbarimit të vizitës, bëhet objekt i një kontrolli të imët, ashtu siç është parashikuar në nenin 2, kreu III, pjesa e dytë, të kësaj rregulloreje.

8. Vizitorët regjistrohen në regjistrin e vizitave.

KREU II VIZITAT ME TË HUAJT E NDALUAR

Neni 1

1. Të huajt të ndaluar duhet t'i jepet mundësia të flasë me vizitorët duke ruajtur konfidencën. Anëtarët e personelit të mbikëqyrjes duhet të tregojnë kujdes gjatë vizitës.

2. Vizita individuale e një avokati, e një përfaqësuesi diplomatik apo e një konsulli, e një deputeti, e një anëtar i qeverie apo përfaqësuesi të pushtetit gjyqësor zhvillohet në një mjedis të ndarë, pa praninë e anëtareve të personelit të Qendrës.

Neni 2

Kur një i huaj i ndaluar është i sëmurë deri në atë shkallë sa që nuk mund të shkojë në dhomën e vizitës, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund ta autorizojë atë të presë vizitorët në dhomën e tij ose në sallën e infermierisë.

Neni 3

1. Kur ekzistojnë tregues seriozë që kontakti midis të huajit të ndaluar dhe një vizitori përbën rrezik për sigurinë kombëtare, sigurinë publike apo rendin publik ose në rastin kur kërkohet marrja e masave parandaluese kundër kryerjes së veprave penale, mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive individuale, mbrojtja e sigurisë së Qendrës, drejtori i Qendrës ose zëvendësuesi i tij mund të marrë një nga masat e mëposhtme ndaj vizitorit:

- a) E paralajmëron me gojë.
- b) Ndërpret vizitën.
- c) I refuzon hyrjen në Qendër.

2. Kur sanksionet e parashikuara në pikën 2 dhe 3 ndërmerren ndaj personave të përmendur në nenin 4 dhe nenin 5, kreu II, pjesa e katërt e kësaj rregulloreje, drejtori i Qendrës duhet të njoftojë menjëherë autoritetin epror shtetëror përgjegjës.

3. Nëse një vizitor tenton të përgatisë apo të ndihmojë në arratisje të huajin e ndaluar, drejtori i Qendrës ose zëvendësuesi i tij kryen veprimet në përputhje me ligjet në fuqi.

KREU III

VIZITAT E PËRFAQËSUESIT DIPLOMATIK APO KONSULLOR, DEPUTETËVE DHE ANËTARËVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV DHE GJYQËSOR, AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 1

1. Të huajt e ndaluar kanë të drejtë të presin, në mënyrë të përditshme dhe midis orës 08.00 dhe orës 20.00, vizita nga përfaqësues diplomatikë apo konsullorë të shtetit të origjinës, pasi kanë marrë konfirmimin nga autoriteti shtetëror përgjegjës për kontrollin e të huajve në territor.

Neni 2

1. Deputetet, anëtarët e qeverisë dhe përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor që paraqiten në Qendër, mund të hyjnë në kontakt me një ose shumë të huaj të ndaluar, duke u identifikuar si të tillë paraprakisht pranë drejtorit të Qendrës apo zëvendësuesit të tij dhe nëse justifikojnë që vizita e tyre është e nevojshme në kuadër të funksionit të tyre.

Neni 3

1. Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë kanë gjithmonë mundësinë të kontaktojnë të ndaluarit në Qendër midis orës 08.00 të mëngjesit deri 20.00 të mbrëmjes, pasi provojnë të qenit të tillë.

KREU IV

VIZITA E ANËTARËVE TË FAMILJES

Neni 1

1. I huaji i ndaluar mund të presë çdo ditë, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në nenin 2, kreu IV, pjesa e katërt, të kësaj rregulloreje, midis orës 08.00 dhe orës 22.00 në kohëzgjatje të paktën një ore,

vizitën e prindërve të tij dhe të të afërmeve në linjë të drejtpërdrejtë, të kujdestarit të tij, të bashkëshortes apo partnerit, të vëllezërve dhe motrave dhe të xhaxhallarëve/dajave apo hallave/tezeve.

2. Këta persona duhet të sjellin qoftë provën e lidhjes së tyre familjare, qoftë provën e bashkëjetesës së tyre me të huajin e ndaluar. Drejtori i Qendrës ose në mungesë, zëvendësuesi i tij apo anëtar i personelit që ai cakton për këtë qëllim, mund të lejojë përjashtim nga ky rregull.

Neni 2

1. Raporti gjatë vizitës është 2 (dy) vizitorë për një të huaj të ndaluar. Drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të lejojë përjashtim nga ky rregull.

2. Fëmijët e moshës nën 12 vjeç mund të shoqërojnë gjithmonë personat e përcaktuar të përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

KREU V VIZITA NGA PERSONA TË TJERË

Neni 1

1. Vizitorë të tjerë pranohen për vizitë pasi kanë marrë një autorizim paraprak nga drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij.

2. Ky autorizim mund të refuzohet vetëm atëherë kur:

a) personi i interesuar nuk paraqet dukshëm asnjë interes të përligjur.

b) ka të dhëna serioze që vizita mund të vërë në rrezik ruajtjen e rendit, sigurisë dhe mirëfunksionimin e Qendrës.

c) ka të dhëna që mund të këtë rrezik për integritetin fizik apo moral e të huajit të ndaluar.

3. Autorizimi do të jetë i vlefshëm me një kohëzgjatje për të paktën 1 (një) orë, me përjashtim të rasteve kur nevojat e shërbimit nuk e lejojnë.

KREU VI RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË VIZITËS NË QENDËR

Neni 1

1. Kryerja e një vizite në Qendër, përjashtuar neni 4 dhe neni 5 të kreut VII të pjesës së katërt të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet autorizimit të drejtorit të Qendrës.

Neni 2

1. Vizitorët e Qendrës shoqërohen gjithmonë nga drejtori i Qendrës, zëvendësuesi i tij apo anëtar i personelit që ai cakton për këtë qëllim.

Neni 3

1. Të huajt e ndaluar nuk mund t'i ekspozohen kureshtisë së publikut. Ata nuk mund t'u nënshtrohen, pa pëlqimin e tyre, pyetjeve të gazetareëve, të personave të tretë apo dhe të personave të përmendur në nenin 4 dhe nenin 5 të kreut VII të pjesës së katërt të kësaj rregulloreje dhe as të filmohen.

Neni 4

1. Autoritetet e mëposhtme kanë gjithmonë akses në Qendër midis periudhës kohore nga 08.00 deri me 20.00 në kuadrin e ushtrimit të funksioneve të tyre:

a) prokurori,

b) avokati,

c) Kryqi i Kuq Shqiptar.

Neni 5

1. Institucionet e mëposhtme dhe anëtarët e tyre kanë akses në Qendër në kuadrin e ushtrimit të misioneve të tyre:

- a) Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR).
- b) Komisioni Europian për të Drejtat e Njeriut.
- c) Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve Çnjerëzore apo Degraduese.
- d) Komiteti i Kombeve të Bashkuara kundër Torturës.
- e) Avokati i Popullit.
- f) Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq.

Neni 6

1. Autoriteti Qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit mund t'u japë të drejtën për të vizituar Qendrën përfaqësuesve të institucioneve të tjera, të organizatave apo personave, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 4 dhe nenin 5 të kreut VII të pjesës së katërt të kësaj rregulloreje, për të cilët nuk është e nevojshme, duke përcaktuar kushtet dhe kohëzgjatjen e vizitës.

KREU VII REGJIMI MORAL DHE FETAR NË QENDËR

Neni 1

1. I huaji i ndaluar mund të informojë për bindjet e tij fetare apo filozofike që ai praktikon dhe nëse dëshiron të marrë pjesë në një kult të caktuar në Qendër.

2. Të huajt e ndaluar, të cilët kanë shprehur dëshirë për të marrë pjesë në një kult të njohur nga shteti, përfitojnë, me kërkesën e tyre, një asistencë morale dhe fetare nga përfaqësuesit e kultit të njohura nga shteti.

3. Përfaqësues të kultit apo këshilltarë moralë pajisen me një kartë identifikimi të lëshuar nga autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Neni 2

1. I huaji i ndaluar duhet të informojë në çdo kohë drejtorin e Qendrës nëse ai praktikon një tjetër kult nga ai që ka deklaruar në fillim.

Neni 3

1. Përfaqësuesit e kultit të njohur nga shteti apo këshilltarët moralë vizitojnë shtetasit e huaj të ndaluar vetëm me dëshirën e tyre.

Neni 4

1. Me qëllim ushtrimin e praktikës morale dhe fetare ngrihet një ambient i posaçëm në Qendër. Të huajt e ndaluar kanë të drejtë të mbajnë sendet e nevojshme për ushtrimin e riteve fetare.

2. Nëse feja e zgjedhur nga i huaji i ndaluar parashikon rregulla në lidhje me ushqimin, drejtori i Qendrës duhet të garantojë respektimin e tyre.

Neni 5

1. Personat e ngarkuar me asistencën morale dhe fetare duhet të respektojnë personelin e Qendrës dhe misionin e tyre, si dhe rregullin e brendshëm në Qendër. Ata duhet të mbajnë një qëndrim asnjanes në kuadrin e dhënies së asistencës në Qendër.

2. Nëse ka tregues serioz se po kryet një përdorim i papërshtatshëm apo abuziv me hyrjen në

Qendër, personeli i Qendrës merr masa të menjëhershme dhe paralajmëron ose refuzon hyrjen në Qendër të personave të ngarkuar me asistencën morale dhe fetare si informon drejtorin e Qendrës menjëherë dhe në rrugë hierarkike informohet autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit.

PJESA E PESTË ASISTENCA DHE HIGJENA NË QENDËR

KREU I ASISTENCA MJEKËSORE

Neni 1

1. Qendra disponon një shërbim mjekësor të gatshëm çdo ditë gjatë orëve të përmendura në rregulloren e brendshme të saj dhe e gatshme në mënyrë permanente në rast urgjence.
2. Drejtori i Qendrës kujdeset që:
 - a) Mjeku i Qendrës, ose kontraktuar nga Qendra, të jetë i gatshëm rregullisht për konsultime.
 - b) Ilaçet e dhëna për të huajt e ndaluar nga mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra të sigurohen falas për të huajt e ndaluar, përshkruhen nga mjeku në kartelën mjekësore mbi mënyrën e përdorimit dhe administrohen vetëm sipas regjimit të kurimit.
 - c) Të njoftohet shërbimi mjekësor kur një i huaj i ndaluar refuzon të marrë ilaçet që i janë dhënë nga mjeku. Ky refuzim të shkruhet në kartelën mjekësore të tij.

Neni 2

1. Kur një i huaji i ndaluar sëmuret, shërbimi mjekësor, nën përgjegjësinë e mjekut të Qendrës ose kontraktuar nga Qendra, kujdeset për gjendjen e tij shëndetësore.
2. Mjeku i Qendrës, ose kontraktuar nga Qendra, ruan pavarësinë e tij profesionale në raport me drejtorin e Qendrës. Vlerësimet apo vendimet e tij që kanë të bëjnë me shëndetin e të huajve të ndaluar bazohen vetëm në kritere mjekësore.
3. I huaji i ndaluar mund të thërrasë mjekun me dëshirën e tij, duke mbuluar privatisht shpenzimet. Ai duhet të njoftojë për këtë mjekun e Qendrës ose kontraktuar nga Qendra.
4. Natyra e mjekimit dhe trajtimit e përshkruar nga mjeku që nuk i përket Qendrës duhet t'i bëhet me dije mjekut të Qendrës ose kontraktuar nga Qendra me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së trajtimit. Nëse mjeku që nuk i përket Qendrës dhe mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra nuk bien dakord në lidhje me trajtimin, mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra referon rastin për ekzaminim në shërbimin e specializuar të spitalit rajonal.

Neni 3

1. Vetëm mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra vendos nëse i huaji i ndaluar mund të trajtohet në ambientet e përbashkëta apo duhet transferuar në sallën e infermierisë.
2. Ky mjek dhe/ose bashkëpunëtorët e tij evidentojnë në dosjen mjekësore të të huajt të ndaluar ekzaminimet dhe shënimet që kanë të bëjnë me të.

Neni 4

1. Nëse mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra konstaton që i huaji i ndaluar sëmuret me ndonjë infeksion që nuk mund të trajtohet në mënyrë të përshtatshme në Qendër ose në rast lindjeje apo rrezik vdekjeje, i huaji transferohet drejt një qendre mjekësore të specializuar. Drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij duhet të njoftojë për këtë autoritetin e pror.

Neni 5

1. Kur një i huaj i ndaluar transferohet drejt një qendre të specializuar mjekësore, drejtori i Qendrës merr masa për shoqërimin dhe mbikëqyrjen e tij gjatë gjithë kohës, në bashkëpunim me drejtorin e Qendrës së specializuar mjekësore apo zëvendësuesin e tij.

Neni 6

1. Drejtori i Qendrës merr masa që të zhvillohen me të ndaluarit konsultat nga mjekë të specializuar, konsulta të gjykuara të nevojshme nga mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra dhe të ndiqen trajtimet e përcaktuara nga këta specialistë.

Neni 7

1. Në rast të infeksioneve të rënda, sëmundjeve ngjitëse ose epidemive, mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur drejtorin e Qendrës apo zëvendësuesin për masat që duhet të merren.

2. Në rastet sipas përcaktimeve apo udhëzimeve nga institucionet përgjegjëse në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë mbi sëmundjet ngjitëse apo epidemitë, mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra informon menjëherë Institutin e Shëndetit Publik, ndërsa drejtori i Qendrës duhet të përgatisë një raport dhe t’ia transmetojë atë autoritetit epror.

Neni 8

1. Nëse një i huaj izolohet, bazuar në germën “d”, pika 1, neni 2, kreu IV, pjesa e gjashtë të kësaj rregulloreje, duhet njoftuar menjëherë personeli i shërbimit mjekësor. Personeli mjekësor në Qendër i bën vizitë të izoluarit në afatet më të shkurtra dhe vë në dijeni menjëherë mjekun e Qendrës ose kontraktuar nga Qendra për masën e marrë dhe për gjendjen shëndetësore të tij. I izoluari ndiqet në vazhdim në mënyrë të përditshme.

Neni 9

1. Mjeku i Qendrës apo kontraktuar nga Qendra plotëson çdo ditë dokumentacionin mjekësor lidhur me shërbimin mjekësor ndaj të huajve të ndaluar në Qendër duke pasqyruar në kartelën mjekësore vizitën mjekësore të kryer, barnat e rekomanduara, ekzaminimet mjekësore, rastet e referimeve për trajnim të specializuar, si dhe konsultat që kryhen.

2. Dosja mjekësore mund të konsultohet në të gjitha rastet nga mjeku të cilin i huaji i ndaluar e ka thirrur me shpenzimet e veta, në përputhje me pikën 3, nenin 2 të kreut I, pjesa e pestë, të kësaj rregulloreje. Mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra vendos për konsultimin e dokumenteve në dosjen mjekësore.

Neni 10

1. Kur mjeku i Qendrës ose kontraktuar nga Qendra formulon kërkesa mjekësore që lidhen me moslargimin nga territori i të huajit të ndaluar ose është i mendimit që shëndeti mendor apo fizik i tij është seriozisht i rrezikuar nga ndalimi apo ndonjë rrethanë tjetër, këto kërkesa apo ky mendim i parashtrohet në mënyrë hierarkike nga drejtori i Qendrës nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës për kontrollin e të huajve në territor, Ministrin të Brendshëm, i cili mund të pezullojë ekzekutimin e masës së largimit nga territori apo masën e ndalimit në Qendër.

2. Kur Ministri nuk e gjykon të nevojshme të pezullojë ekzekutimin e masës së largimit nga territori apo të izolimit, ai duhet të kërkojë paraprakisht mendimin e një mjeku të specializuar të vënë në dispozicion nga institucioni i Ministrisë së Shëndetësisë. Nëse ky mjek i konfirmon të bazuara kërkesat apo mendimin e mjekut të Qendrës ose kontraktuar nga Qendra, Ministri (autoriteti) duhet të pezullojë ekzekutimin e masës së largimit nga territori apo masën e ndalimit në Qendër.

3. Kur mjeku i dytë i vënë në dispozicion nga institucioni i Ministrisë së Shëndetësisë nuk konfirmon kërkesat apo mendimin e mjekut të Qendrës, mendimi i një konsulte mjekësh do të jetë përcaktues. Nëse konsulta e mjekeve konfirmon kërkesat apo mendimin e mjekut të Qendrës ose kontraktuar nga Qendra, Ministri (autoriteti) duhet të pezullojë ekzekutimin e masës së largimit nga territori apo masën e ndalimit në Qendër.

Neni 11

Izolimi mjekësor

1. Në rastet e sëmundjeve ngjitëse, mjeku vendos për izolimin e të ndaluarve, duke e mbajtur nën

kontroll të vazhdueshëm dhe njofton inspektoratin epidemiologjik.

2. Mjeku vendos pushimin e izolimit, pas vendimit të inspektoratit epidemiologjik.

3. Në rastet e konstatimit, dhoma dezinfektohet, ndërsa i ndaluari izolohet në një ambient të veçantë ose dërgohet në spitalin e posaçëm për mjekim të specializuar.

Neni 12

Të ndaluarit me çrregullime dhe sëmundje mendore

1. Të ndaluarit që konstatohen se vuajnë nga çrregullime të rënda mendore, nga sëmundje dhe të meta të tjera mendore dërgohen në afatin më të shkurtër të arsyeshëm për konsulte me mjekun specialist psikiatër nëpërmjet spitalit psikiatrik rajonal ose qendrës komunitare të shëndetit mendor.

2. Në varësi të diagnozës dhe propozimit për trajtim të mëtejshëm nga mjeku psikiatër, Qendra me anë të mjekut dhe psikologut të saj merr masa për trajtimin e të ndaluarit me sëmundje apo të meta mendore brenda infrastrukturës dhe mundësive që ka Qendra ose trajtimin e tij në shërbimin spitalor.

Neni 13

Asistenca gjatë periudhës së shtatzënisë dhe menjëherë pas lindjes

1. Kurdoherë që është e mundur praktikisht, fëmijët duhet të linden në një spital jashtë Qendrës. Gratë e ndaluara shtatzëna dhe ato lehonat duhet të asistohen nga specialistë të obstetrikës dhe gjinekologjisë dhe nga personel paramjekësor.

2. Kujdesi shëndetësor parandalues dhe kurativ për moshën pediatrike të neneve të ndaluara të ofrohet nga mjekë pediater.

3. Në qoftë se një fëmijë lind në Qendër, ky fakt nuk pasqyrohet në certifikatën e lindjes.

4. Në interes të fëmijës dhe të grave të ndaluara para lindjes dhe lehonë pas lindjes, Autoriteti Qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit, me propozim të drejtorit të Qendrës, bazuar dhe në epikrizat mjekësore, mund të vendosë për ndërprerjen e mbajtjes në qendër për këto kategori dhe marrjen e vendimit për të qëndruar në një territor të caktuar.

5. Drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij i transmeton autoritetit epror një raport të shoqëruar me një epikrizë mjekësore të mjekut të Qendrës në lidhje me çdo grua që mendohet se do të lindë gjatë periudhës së qëndrimit në Qendër.

6. Drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij njofton lindjen e një fëmije brenda tri ditëve pranë nëpunësit të gjendjes civile të njësisë vendore në juridiksionin e së cilës është kryer lindja, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”.

KREU II

ASISTENCA JURIDIKE

Neni 1

1. I huaji i ndaluar në Qendër gëzon të drejtën e asistencës juridike.

2. Drejtori i Qendrës merr masa që i huaji i ndaluar të ketë mundësinë e ndihmës juridike të parashikuar nga ligji.

Neni 2

1. Të huajt e ndaluar kanë të drejtën t'i telefonojnë për ditë dhe falas avokatit të tyre midis orës 08.00 të paradites dhe orës 20.00 të mbrëmjes.

2. Avokatët kanë të drejtën të hyjnë në kontakt telefonik me klientët e tyre në çdo moment.

3. Kontakti telefonik midis klientit dhe avokatit nuk mund të ndalohej.

Neni 3

1. Avokatët dhe përkthyesit që asistojnë avokatët hyjnë në Qendër çdo ditë brenda orës 08.00 deri në 20.00, nëse ata kanë klientin e tyre në Qendër dhe nëse provojnë të qenin të tillë me anë të një kartë të vlefshme të ushtrimit të këtij profesioni.

2. Vizita e avokatit nuk mund të ndalohej.

Neni 4

1. Kur ekzistojnë tregues seriozë që vizita në Qendër e një përkthyesi përbën rrezik për sigurinë kombëtare, sigurinë publike apo rendin publik ose kur kërkohet marrja e masave parandaluese kundër kryerjes së veprave penale, mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive individuale apo mbrojtja e sigurisë së Qendrës, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të marrë masat e mëposhtme ndaj përkthyesit:

- a) Të bëjë një paralajmërim me gojë.
- b) Të ndërpresë vizitë.
- c) Të refuzojë hyrjen në Qendër.

2. Kur drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij merr masat e përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ai duhet ta njoftojë menjëherë autoritetin e prap.

3. Nëse një përkthyes tenton të ndihmojë apo të përgatisë një arratisje nga Qendra, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

1. Nëse ka tregues seriozë se është kryer një përdorim i papërshtatshëm apo abuziv me të drejtat e përcaktuara në nenin 2 dhe nenin 3 të këtij kreu, njoftohet Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma e Avokatëve.

KREU III ASISTENCA SOCIALE, KOHA E LIRË DHE ZHVILLIMI I PËRGJITHSHËM

Neni 1

1. Qendra disponon një shërbim social që funksionon për orët e caktuara me rregullore të brendshme të Qendrës.

Neni 2

1. Shërbimi social ndjek, në bashkëpunim me shërbimin mjekësor, shoqërimin psikologjik dhe social të të huajit të ndaluar gjatë qëndrimit të tij në Qendër dhe e përgatit atë për largimin nga territori. Shërbimi social e asiston të huajin e ndaluar me qëllim që të respektohet vendimi i marrë në lidhje me pozitën e tij ligjore në raport me ligjin për të huajt.

Neni 3

1. Drejtori i Qendrës duhet të favorizojë zhvillimin individual të të huajve të ndaluar. Ai mund të ngarkojë anëtarë të personelit për të organizuar aktivitete të rëndësishme që mundësojnë arritjen e këtij qëllimi.

Neni 4

1. Në funksion të infrastrukturës dhe mundësive të Qendrës, shërbimi social apo anëtarët e personelit që ngarkohen me këtë mision nga drejtori i Qendrës organizojnë aktivitetet argëtuese, kulturore, sportive për të huajt e ndaluar.

Neni 5

1. Qendra duhet të disponojë një bibliotekë, librat e së cilës të jenë në dispozicion të të huajve të ndaluar.

Neni 6

1. Të huajt e ndaluar kanë akses për ditë në informacionet që përhapen nga mediat e ndryshme, në kushtet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Qendrës.

2. Në rast abuzimi apo në interes të sigurisë kombëtare, të sigurisë publike, mbrojtjes së rendit

publik apo kur kërkohet marrja e masave parandaluese kundër veprave penale, mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive individuale apo siguria e Qendrës, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund ta kufizojë këtë akses. Për këtë ai duhet të informojë menjëherë në rrugë hierarkike autoritetin epror.

KREU IV VEPRIMTARIA E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE DHE ORGANIZATAVE TË TJERA NË QENDËR

Neni 1

1. Autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit mund të autorizojnë organizatat jofitimprurëse apo organizatave të tjera të organizojnë aktivitete në Qendër duke respektuar kushtet e mëposhtme:

a) Aktivitetet zhvillohen në dobi të të huajve të ndaluar mbi një bazë të rregullt dhe në mënyrë profesionale.

b) Aktivitetet nuk mund të zhvillohen në kundërshtim me legjislacionin për të huajt apo me këtë rregullore.

c) Aktivitetet të jenë pjesë e një plani vjetor aktiviteteve të miratuara më parë nga autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit.

d) Organizata duhet të ofrojë një garanci për vazhdimësinë e aktiviteteve.

e) Aktivitetet duhet të kryen në bashkëpunim me drejtorin e Qendrës dhe personelin që punon në Qendër.

f) Aktivitetet e organizatës duhet të vlerësohen çdo vit.

2. Nëse ka të dhëna serioze se është bërë një përdorim i papërshtatshëm apo abuziv me autorizimin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, informohet menjëherë në mënyrë hierarkike autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Neni 2

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me kërkesë të drejtorit të Qendrës, nëpërmjet autoritetit qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit, mund të vërë në dispozicion të tij për organizimin e aktiviteteve që përmenden në nenet 4 dhe 5 të kreut III, të pjesës së pestë të kësaj rregulloreje, personel të specializuar që nuk i përkasin strukturave të policisë kufitare dhe migracionit.

KREU V MIRËMBAJTJA, HIGJIENA DHE USHQIMI

Neni 1

Ambienti

1. Vendet të cilat kushtet e sigurisë dhe qëndrimi e diktojnë, duhet të jenë të ndriçuara nga mbrëmja deri në mëngjes.

2. Në të gjitha ambientet e brendshme duhet të ekzistojë një temperaturë e përshtatur.

3. Administrata e Qendrës duhet të marrë të gjitha masat për të garantuar një ajrosje dhe një higjiene të mirë të Qendrës.

Neni 2

Veshja

1. Të huajt e ndaluar mbajnë veshjet e tyre, përveç rasteve kur drejtori i Qendrës vendos ndryshe për arsye sigurie, modaliteti dhe higjiene.

2. Të huajt mund të blejnë me shpenzimet e tyre veshje për të cilat kanë nevojë.

3. Nëse veshjet nuk janë të përshtatshme, Qendra i siguron ato falas për të huajin e ndaluar në Qendër.

Neni 3

1. Veshjet dhe shtresat për të huajt e ndaluar duhet t'u korrespondojnë temperaturave stinore. Ato mbahen të pastra dhe në gjendje të mirë dhe lahen rregullisht në ambiente të posaçme të krijuara në Qendër sipas një grafiku të miratuar nga drejtori i Qendrës.

2. Materialet e infermierisë pastrohen apo lahen veças atyre të ndaluarve në Qendër.

Neni 4

Higjiena personale dhe e mjedisve

1. I ndaluari është i detyruar të kujdeset vazhdimisht për higjienën dhe pamjen e pastër e të rregullt të tij, si dhe të mbajë pastër e të rregullt dhomën dhe ambientet e përbashkëta.

2. Për këtë qëllim, ata lejohen të mbajnë brisqe rroje me mbulesë plastike, pastë rroje dhe solucion me ambalazhe plastike, sapunë, peshqirë, pastë dhëmbësh etj. Për rastet kur nuk mund të përballohen nga i ndaluari, u sigurohen nga Qendra falas.

3. Qethja e të ndaluarve bëhet një herë në muaj nga berberi i kontraktuar nga Qendra, ndërsa rruarja nga berberi mund të bëhet vetëm në rastet kur i ndaluari nuk është i aftë për t'u rruajtur vetë dhe me pëlqimin e tij.

4. Larja e të ndaluarve bëhet jo më pak se një herë në javë, sipas grafikut të hartuar dhe zbatohet brenda orarit maksimal të veprimeve. Larja e të ndaluarve mund të bëhet edhe më shpesh, sipas nevojave të tyre.

5. Detergjentët pastrues e dezinfektues dhe mjetet e tjera për pastrim sigurohen nga Qendra, por lejohen që t'i sigurojnë dhe vetë të ndaluarit me shpenzimet e tyre.

6. Kontrolli higjieno-sanitar i dhomave dhe i ambienteve të përbashkëta bëhet çdo ditë nga personeli i shërbimit në Qendër.

Neni 5

Pastrimi i dhomave

1. Të ndaluarve u kërkohet të punojnë deri në 30 orë në muaj, me qëllim që të mbajnë pastër dhomat e tyre dhe ambientet e tjera të përbashkëta. Për këtë qëllim, atyre duhet t'u garantohet uji, detergjentët pastrues dhe dezinfektues, si dhe mjetet e tjera të nevojshme për pastrim.

2. Rregullat e pastrimit dhe kontrolli i tyre përcaktohen nga rregullorja e brendshme e Qendrës.

Neni 6

Ushqimi

1. Çdo i huaj i ndaluar merr ushqim tre herë në ditë sipas normave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për këtë qëllim. Në bazë të rekomandimit të mjekut, mund t'u ofrohet një ushqim shtesë apo ushqim dietetik.

2. Lejohet blerja e produkteve ushqimore, cigareve etj. në pajisjet automate të instaluar në Qendër, me të ardhurat që i huaji i ndaluar ka në llogarinë e tij në arkën e institucionit.

3. Në qoftë se i ndaluari, për shkak të besimit fetar kërkon një ushqim të ndryshëm, kjo kërkesë duhet respektuar nga administrata e Qendrës në përputhje me rregullat fetare dhe mundësitë praktike të institucionit.

Neni 7

1. Ndalohet konsumimi dhe përdorimi i pijeve alkoolike, pijeve të ndaluara apo të rrezikshme në Qendër.

Neni 8
Gatimi dhe shpërndarja e ushqimit

Ushqimi duhet të gatuhet në ambiente të posaçme të Qendrës dhe u shërbehet të ndaluarve sipas grafikut të konfirmuar nga drejtori i Qendrës në ambiente të posaçme.

Në raste të veçanta, siç janë festat zyrtare, ritet fetare, ngjarje të jashtëzakonshme etj., me miratimin e drejtorit të Qendrës ky orar mund të ndryshohet.

KREU VI
RREGULLA TË JETESËS

Neni 1

1. Përdorimi i kohës nga çdo i huaj i ndaluar, organizimi dhe ndjekja e aktiviteteve në Qendër, përcaktohen me rregullore të brendshme të Qendrës.

Neni 2

1. Çdo i huaj i ndaluar ka të drejtë të shëtisë minimalisht 2(dy) orë në ditë në mjediset e jashtme të Qendrës.

2. Për arsye mjekësore apo në interes të të ndaluarit, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të vendosë ndryshe.

3. Kohëzgjatja e shëtitjes për arsye sigurie mund të kufizohet, por i huaji i ndaluar duhet gjithmonë të ketë mundësinë të shëtisë një orë në ditë.

4. Kur një i huaj i ndaluar, me sjelljen e tij vë në rrezik sigurinë e tij, sigurinë e të huajve të tjerë të ndaluar, të anëtarëve të personelit apo të Qendrës, apo kërcënon mirëfunksionimin e saj, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij mund të bëjnë përjashtim nga ky rregull. Drejtori i Qendrës informon menjëherë në rrugë hierarkike autoritetin epror.

Neni 3

1. Qëndrimi në Qendër gjatë ditës karakterizohet nga jeta në grup.

2. Drejtori i Qendrës merr masat e nevojshme me qëllim që të garantojë që vetëm anëtarë të personelit të të njëjtit seks me të huajt e ndaluar të jenë të pranishëm gjatë periudhave të kryerjes së aktiviteteve të higjienës.

3. Gjatë periudhave të kryerjes së aktiviteteve të higjienës dhe gjumit, gratë dhe burrat janë të ndarë në të gjitha rastet.

4. Drejtori i Qendrës vë në dispozicion të të huajve të ndaluar infrastrukturën e nevojshme me qëllim respektimin e nevojave të jetës së tij private.

5. Nëse për arsye të forta, në Qendër qëndrojnë të mitur, në dispozicion të tyre duhet të vihet infrastruktura e përshtatur në mënyrë që ata të mos vihen në vështirësi.

Neni 4

1. Në rastet e mëposhtme, mund të bëhet përjashtim nga regjimi i jetës në grup:

a) Për kategori të veçanta personash:

a.a) Për arsye mjekësore, në përputhje me nenin 5, kreu I, pjesa e pestë e kësaj rregulloreje;

a.b) për pritje të anëtarëve të familjes.

b) Për arsye të ruajtjes së rendit dhe sigurisë:

b.a) izolimi i të huajt të ndaluar, i cili, me sjelljen e tij, vë në rrezik sigurinë dhe qetësinë e grupit;

b.b) izolimi si masë e ruajtjes së rendit, në përputhje me germën “d”, pika 1, neni 2, kreu IV, pjesa e VI të kësaj rregulloreje.

c) Në kuadrin e largimit nga territori:

c.a) izolim paraprak për realizimin efikas të largimit nga territori të të huajt të ndaluar.

PJESA E GJASHTË
REGJIMI DISIPLINOR

KREU I DETYRIMET E TË HUAJIT TË NDALUAR

Neni 1

1. I huaji i ndaluar duhet të sillet në përputhje me rregullat e jetesës të përshkruara në këtë rregullore dhe në rregulloren e brendshme të Qendrës në të cilën ai qëndron. Ai është i detyruar të ndjekë orientimet e personelit me qëllim që të ruhet rendi në brendësi të Qendrës dhe të respektojë rregulloret.

Neni 2

1. I huaji i ndaluar duhet të këtë gjithmonë me vetë kartën e identifikimit që i është lëshuar në përputhje me rregulloren e brendshme.

Neni 3

1. I huaji i ndaluar kujdeset për veshjet e tij dhe higjienën e tij personale.

Neni 4

1. Të huajve të ndaluar u ndalohet të dëmtojnë pastërtinë dhe gjendjen e të mirave materiale të tundshme dhe të patundshme të Qendrës.

2. Të huajt e ndaluar kujdesen që ambientet në të cilat ata qëndrojnë të jenë në rregull dhe të përmbushin kushtet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Qendrës.

3. Për dëmet e qëllimshme, të shkaktuara nga i huaji i ndaluar autoriteti i Qendrës mund të kërkojë rimbursim nga i huaji që ka shkaktuar dëmin.

Neni 5

1. Të gjitha aktet që komprometojnë sigurinë, rendin dhe mirëfunksionimin e Qendrës janë të ndaluara.

Neni 6

1. I huaji i ndaluar ndjek procedurat përkatëse në lidhje me përdorimin vetjak të veglave të rojës dhe objekteve të tjera të rrezikshme me të cilat ai mund të abuzojë. Këto procedura përshkruhen në rregulloren e brendshme të Qendrës.

Neni 7

1. Të huajt e ndaluar ndjekin orarin e veprimeve dhe lëvizjen në grup sipas mënyrës së përshkruar në rregulloren e brendshme.

KREU II TË DREJTAT E TË HUAJIT TË NDALUAR NË QENDËR

Neni 1

1. Regjimi disiplinor synon vetëm ruajtjen dhe mbajtjen e rendit dhe garantimin e sigurisë dhe mirëfunksionimin e Qendrës.

Neni 2

1. Asnjë i huaj i ndaluar nuk mund të ngarkohet me mbajtjen e disiplinës në Qendër.

2. Të huajt e ndaluar mund të ngarkohen me përgjegjësi të veçanta gjatë zhvillimit të aktiviteteve në Qendër .

Neni 3

1. Ndaj një të huaji të ndaluar, mund të merren vetëm masat e përshkruara nga dhe në zbatim të kësaj rregulloreje. Vetëm shkeljet e përshkruara nga dhe në zbatim të kësaj rregulloreje mund t'i paraprijnë marrjes së masave ndaj një të huaji të ndaluar.

Neni 4

1. Ndaj një të huaji të ndaluar mund të ndërmerret një masë sigurie lidhur me një procedurë disiplinore ose procedure penale të nisur, kur konstatohet se ai kryen një shkelje disiplinore apo shkelje penale.

2. Një masë sigurie nuk mund të merret dy herë kundrejt të huajit të ndaluar për të vetmen dhe të njëjtën shkelje.

KREU III SHKELJET

Neni 1

1. Vetëm faktet e mëposhtme konsiderohen si shkelje dhe mund të ndiqen nga marrja e masave të sigurisë:

a) Shkelje serioze dhe të përsëritura kundrejt anëtarëve të personelit dhe personave të tjerë, të cilat cenojnë autoritetin e tyre.

b) Shkelje serioze dhe të përsëritura kundrejt të huajve të tjerë të ndaluar.

c) Qëndrimi pa leje në një hapësirë apo ambient ku ata nuk janë të autorizuar të hyjnë apo të gjenden jashtë periudhës kohore të autorizuar dhe të prishin kështu rendin, sigurinë apo mirëfunksionimin e Qendrës.

d) Blerje apo shitje apo oferta për këtë qëllim midis të huajve të ndaluar, përveç se kur ka pasur autorizim nga drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij.

e) Zotërimi apo përdorimi i objekteve apo substancave të ndaluara.

f) Kur nuk i binden paralajmërimeve apo urdhrave të personelit të Qendrës, përjashtuar rastet kur ato janë dukshëm të papërligjura.

g) Shkatërrimi dhe prishja e qëllimshme e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të tjetrit dhe të objekteve të vena apo të lëna në dispozicion të të huajve të ndaluar me kusht që ato të ruheshin në gjendje të mirë.

h) Cenimi i sigurisë, prishja e rendit dhe mirëfunksionimit të Qendrës apo fakti që nuk i përmbahen një marrëveshjeje, e cila komprometon mirëfunksionimin e Qendrës apo një marrëveshjeje për të cilën autoritetit shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve në territor i është dashur të marrë masa.

i) Vjedhja, mashtrimi, korrupsioni aktiv apo pasiv.

j) Kërcënimet me cenim të integritetit fizik të personave apo me shkatërrim dhe prishje të të mirave materiale.

k) Goditjet e qëllimshme dhe plagosje me dashje.

l) Kryerja e akteve me qëllim arratisje apo ndihmë për arratisje.

m) Mosnjohja e qëllimshme me detyrimet e përcaktuara me shkrim, nga apo në zbatim të kësaj rregulloreje apo nga rregullorja e brendshme e Qendrës.

2. Konsiderohen gjithashtu si shkelje të cilat mund të ndiqen nga masa sigurie, tentativa për shkelje të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe bashkëpunimi në këto lloj shkeljesh.

KREU IV MASAT E SIGURISË

Neni 1

Për zgjedhjen e masës së sigurisë, merret në konsideratë natyra dhe rëndësia e shkeljes së kryer, rrethanat në të cilat ka ndodhur dhe në sa ka vend merren në konsideratë rrethana lehtësuese.

Neni 2

1. Masat e sigurisë që zbatohen janë:
 - a) Paralajmërim me gojë.
 - b) Detyra të imponuara që lidhen me mirëmbajtjen dhe pastërtinë e Qendrës.
 - c) Heqja e mundësive, për aq kohë sa ka një lidhje direkte apo indirekte midis shkeljes dhe masës së marrë, si hyrja në bibliotekë, në hapësirën argëtuese, apo aktivitetet kulturore, sportive apo shplohëse dhe mundësive të tjera të parashikuara në zbatim të kësaj rregulloreje apo rregullores së brendshme të Qendrës.
 - d) Izolimi.
2. Masat e sigurisë të parashikuara në germën “a”, pika 1 të këtij neni, mund të jepen nga anëtarët e personelit.
3. Masa e sigurisë se parashikuar në germën “b”, pika 1 të këtij neni, mund të jepet nga drejtori i Qendrës ose zëvendësuesi i tij apo anëtarët e personelit, të paktën të niveleve që vijnë pas tyre të cilët janë përcaktuar në rregulloren e brendshme për këtë qëllim.
4. Masat e sigurisë të parashikuara në germën “c” dhe germën “d”, pika 1 të këtij neni, jepen vetëm nga drejtori i Qendrës ose nga zëvendësuesi i tij.
5. Izolimi mund të urdhërohet si rezultat i shkeljeve të parashikuara në gjerat “g”, “i”, “j”, “k”, “l” të nenit 1, kreu III, pjesa e gjashtë të kësaj rregulloreje apo kur një i huaj i ndaluar kryen për herë të tretë një shkelje në përputhje me gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “h”, “m” të nenit 1, kreu III, pjesa e gjashtë të kësaj rregulloreje.
6. Nëse shkelja apo kundërshtimi kryhet ndaj drejtorit të Qendrës, është zëvendësuesi i tij që merr masën e sigurisë.
7. Të gjitha masat e sigurisë të marra do të shënohen nga drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij në dosjen individuale të të huajit të ndaluar, dosje e cila ruhet në Qendër.
8. Nëse shkelja është kryer gjatë një lëvizjeje jashtë Qendrës, anëtarët e personelit të shoqërimit janë kompetentë për marrjen e masave të sigurisë.

Neni 3

1. Masat e sigurisë të përmendura në germën “c”, pika 1, neni 2, kreu IV, pjesa e gjashtë të kësaj rregulloreje mund të merren qoftë veçmas, qoftë së bashku. Ato mund të zbuten apo të hiqen nga drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij gjatë kohës së zbatimit të tyre.

Neni 4

1. Kohëzgjatja e masave të sigurisë të përmendura në germën “b” dhe germën “c”, pika 1, neni 2, kreu IV, pjesa e gjashtë të kësaj rregulloreje nuk mund t’i kalojë pesë ditë. Në rast përsëritje kohëzgjatja maksimale caktohet dhjetë ditë.

Neni 5

1. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit në një dhome izolimi është 24 orë. Nëse sjellja e të huajit të ndaluar e pamundëson integrimin e tij në gjirin e grupit, autoriteti epror mund të vendosë zgjatjen dy herë radhazi të këtij afati 24 orësh. Nëse shkelja për të cilën është marrë masa e izolimit përbën vepër penale dhe për të ka filluar procedimi penal, kohëzgjatja e izolimit caktohet nga autoritetet përgjegjëse të hetimit.

Neni 6

1. Drejtori i Qendrës mund t’i propozojë në mënyrë hierarkike autoritetit epror të urdhërojë menjëherë izolimin e të huajit të ndaluar për një kohëzgjatje prej 24 orësh në rastet e mëposhtme:
 - a) kërcënime me cenim të integritetit fizik të personave apo shkatërrim, apo prishje të të mirave materiale;
 - b) goditje të qëllimshme dhe shkatërtim i plagosjeve me dashje;
 - c) kryerja e akteve me qëllim arratisje apo dhënie ndihme për arratisje.
2. Në rastet e mësipërme, autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit mund ta zgjasë afatin e izolimit vetëm njëherë 24 orë.
- Përtej afatit 72 orësh, vetëm autoriteti qendror i Policisë Kufitare dhe Migracionit ka të drejtë të zgjasë afatin e izolimit maksimalisht në një kohëzgjatje deri në 5 (pesë) ditë.

Neni 7

1. Dhoma e izolimit duhet të ketë të paktën një dyshek dhe tualetin, si dhe një sistem alarmi që i lejon të huajt të ndaluar të thërrasë një anëtar të personelit.
2. Dysheku dhe letra e tualetit mund të hiqen maksimumi prej një orë, në rast të një përdorimi të papërshtatshëm apo abuziv të tyre.

Neni 8

1. I huaji i ndaluar duhet të informohet paraprakisht për motivet si rezultat i të cilave ai është bërë objekt i masës së izolimit.

KREU V MASAT SHTRËNGUESE

Neni 1

1. Masat shtrënguese mund të përdoren vetëm atëherë kur sjellja e të huajt të ndaluar përbën një rrezik për veten, për të huajt e tjerë të ndaluar, për anëtarët e personelit apo për sigurinë, rendin apo të mirat materiale të Qendrës apo për persona të trete. Masa shtrënguese duhet të jete e arsyeshëm dhe në proporcion me qëllimin për të cilin jepet.
2. Masat shtrënguese nuk janë sanksione, por mjete për të ruajtur kontrollin e të huajt të ndaluar.
3. Masat shtrënguese të autorizuara janë:
 - a) përdorimi i forcës fizike,
 - b) prangosje e duarve dhe /ose e këmbëve.
4. Nëse masa e parë dështon, mund të merren masat dënuese pasuese.
5. Prangosja e duarve dhe/ose e këmbëve mund të kryhet vetëm me urdhër të drejtorit të Qendrës apo zëvendësuesit të tij. Drejtori i Qendrës duhet të informohet nga personeli për çdo rast të përdorimit të forcës.

PJESA E SHTATË SIGURIA DHE RUAJTJA E RENDIT PUBLIK

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Drejtori i Qendrës siguron praninë e vazhdueshme të një numri minimal të anëtarëve të personelit me qëllim për ruajtjen dhe sigurinë Qendrës.

Neni 2

1. Drejtori i Qendrës inspekton rregullisht Qendrën për t'u siguruar se të huajt e ndaluar, anëtarët e personelit dhe persona të trete e zbatojnë këtë rregullore dhe rregulloren e brendshme në mënyre rigoroze.

Neni 3

1. Në intervale të rregullta apo me urdhrin e drejtorit të Qendrës, mjediset e qëndrimit të përditshëm kontrollohen nga personeli i sigurisë së Qendrës me qëllim kërkimin e objekteve të rrezikshme apo të ndaluara. Ky inspektim kryhet gjithmonë të paktën nga dy anëtarë të personelit të sigurisë. Nëse gjykohet e nevojshme, të huajt e ndaluar kontrollohen gjithashtu në përputhje me dispozitat e nenit 2, kreu III, pjesa e dytë të kësaj rregulloreje.

Neni 4

1. Në rast të prishjes së rendit apo të një kërcënimi të rëndë për sigurinë e Qendrës, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij merr masat në funksion të rrethanave dhe informon menjëherë në mënyrë hierarkike autoritetin shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve në territor. Në këtë rast personeli zbaton dispozita specifike të rregullores së brendshme.

Neni 5

1. Kur vlerësohet e nevojshme për sigurinë e Qendrës, drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij kërkon asistencën e shërbimeve të tjera policore.

Neni 6

1. Infrastruktura e Qendrës, përveç të tjerash përbëhet nga sistem i vëzhgimit dhe monitorimit me kamera. E gjithë infrastruktura e Qendrës inspektohet çdo vit nga një komision i ngritur nga Ministri i Brendshëm.

KREU II ARRATISJA NGA QENDRA

Neni 1

1. Sapo konstatohet një arratisje apo një tentativë arratisjeje nga Qendra, lajmërohet menjëherë drejtori i Qendrës apo zëvendësuesi i tij, i cili krahas masave që merr informon menjëherë autoritetin epror.

Neni 2

1. Personeli i shërbimit në Qendër, në rastet e arratisjeve, njofton menjëherë shërbimet policore lokale dhe rajonale për arratisjen dhe në vazhdim transmetohen të dhënat e mëposhtme: numri i arratisurve, emri, mbiemri, datëlindja, shtetësia dhe fotografia/të.

KREU III RREZIKU I VETËVRASJES

Neni 1

1. Të huajt e ndaluar, të cilët paraqesin një rrezik serioz për vetëvrasje, mund të izolohen nga grupi. Ata kontrollohen rregullisht nga Qendra dhe ndiqen në mënyrë rigoroze nga shërbimi mjekësor dhe social.

Neni 2

1. Drejtori i Qendrës mund të vërë pranë të huajt të ndaluar që paraqet shenja të veçanta vetëvrasjeje, të huajt të tjerë të ndaluar, të cilët kanë fituar besimin e tij.

Neni 3

1. Në rast tentative vetëvrasjeje, thirret shërbimi mjekësor dhe kur është e nevojshme thirren dhe shërbimet e urgjencës. Drejtori i Qendrës informohet menjëherë për ngjarjen. Ai përpilon një raport shërbimi dhe informon sa më shpejt autoritetin epror.

KREU IV RËNIA E ZJARRIT DHE ALARMI PËR BOMBË

Neni 1

1. Anëtari i personelit të Qendrës që konstaton një rënie zjarri, që merr ndonjë mesazh për vendosje të lëndëve eksplozive apo bombë, apo zbulon ndonjë objekt të dyshimtë, duhet të njoftojë menjëherë shërbimet e specializuara. Në vazhdim, ndiqet procedura për shuarjen e zjarrit dhe evakuimit.

2. Drejtori i Qendrës duhet të njoftohet menjëherë për ngjarjen, i cili, me të mbërritur në vend, përpilon një raport shërbimi dhe informon sa më shpejt autoritetin epror.

3. Të paktën një herë në vit në Qendër organizohet një mësim tregues në lidhje me zbatimin e procedurave që duhen ndjekur gjatë alarmeve dhe evakuimeve që kryen si pasojë e ndodhjes së tyre.

Neni 2

1. Evakuimi i të ndaluarve bëhet në varësi të përmasave të rrezikut, por gjithmonë në interes të mbrojtjes së jetës së të ndaluarve. Personeli i Qendrës në çdo rast merr masa si për evakuimin e të ndaluarve, ashtu dhe për ruajtjen e tyre.

2. Nëse zjarri e ka kthyer Qendrën të papërdorshme, të huaj e ndaluar do të transferohen në një qendër tjetër.

PJESA E TETË DETYRIME ADMINISTRATIVE

KREU I LIRIMI APO LARGIMI

Neni 1

1. Kur një i huaj i ndaluar lirohet apo largohet nga Qendra, atij i kthehen objektet e tij personale të depozituara gjatë kontrollit në përputhje me nenin 2, kreu III, pjesa e dytë, të kësaj rregulloreje, me përjashtim të sendeve të rrezikshme apo të ndaluara.

KREU II VDEKJA

Neni 1

1. Kur një i huaj i ndaluar vdes në Qendër, mjeku, në përputhje me rregullat në fuqi, paraqet menjëherë raportin e përpiluar prej tij te drejtori i Qendrës, i cili njofton menjëherë autoritetin epror dhe nëpërmjet autoritetit qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Ministrinë e Punëve të Jashtme.

2. Drejtori i Qendrës njofton gjithashtu menjëherë prokurorin, cili vendos për bërjen ose jo të autopsisë, ose që trupi t'u jepet familjarëve për organizimin e shërbimeve funerale.

Neni 2

1. Trupi i të ndjerit vendoset në morg.

Neni 3

1. Drejtori i Qendrës procedon duke bërë një inventar të objekteve dhe dokumenteve në zotërim të të ndjerit.

Neni 4

1. Kur të afërmit e të ndjerit dëshirojnë të marrin trupin, ata marrin përsipër shpenzimet e transportit të kufomës ose të varrimit në Shqipëri. Nëse nuk dëshirojnë të marrin kufomën, shpenzimet e varrimit merren përsipër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Varrimi bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në varrezat e komunës, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet Qendra.

Neni 5

1. Të hollat dhe sendet personale që i përkasin të ndjerit vihen në dispozicion të të afërmeve, trashëgimtareve të tij apo kujdestarit të tij ligjor. Nëse ata nuk paraqiten brenda 6 muajsh, autoriteti shtetëror përgjegjës për kontrollin e të huajve në territor i poston ato për në vendin e origjinës apo të rezidencës së tij, duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe me përfaqësinë diplomatike apo konsullore të shtetit të origjinës apo të rezidencës së tij të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Nëse Qendra ka informacion për vdekjen dhe sëmundjen e familjareve dhe të të afërmeve të të ndaluarve, ata duhet të njoftohet menjëherë nga drejtori i Qendrës.

KREU III

ANKESAT E TË HUAJVE TË NDALUAR DHE RAPORTI VJETOR

Neni 1

1. Çdo i huaj i ndaluar ka të drejtën të ankohet pranë drejtorit të Qendrës apo zëvendësuesit të tij, duke i drejtuar paraprakisht një kërkesë me shkrim shërbimit social.

2. Pas ankimit te drejtori i Qendrës dhe në rast të moszgjidhjes së kërkesës së tij, i huaji i ndaluar ka të drejtë të ankohet sipas hierarkisë deri te Ministri i Brendshëm.

Neni 2

1. Ministri i Brendshëm ngre një komision të përhershëm, që merret me ankesat individuale të çdo të ndaluar në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Ky komision përbehet nga 3 (tre) anëtarë:

a) Përfaqësuesi i Ministrit - kryetar

b) Përfaqësuesi i drejtorit të përgjithshëm – anëtar

c) Përfaqësuesi i autoritetit qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit -anëtar

3. Ky komision është i ngarkuar të marrë dhe të trajtojë ankesat, të shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës së të huajve të ndaluar dhe të bëjë përpjekje të pajtojë palët e interesuara.

4. Komisioni asistohet nga një raportues, i cili merret me pritjen, trajtimin dhe përpilimin e korrespondencës për këtë qëllim.

5. Pas trajtimit të ankesës, komisioni informon të huajin e ndaluar, drejtorin e Qendrës dhe autoritetin qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit mbi ecurinë e procesit të ankesës.

Neni 3

1. Komisioni mund ta konsiderojë ankesën, plotësisht ose pjesërisht, të bazuar apo të pabazuar.
2. Ankesa konsiderohet e bazuar kur komisioni është i mendimit se vendimi që kërkohet të goditet apo fakti për të cilin është drejtuar ankesa përbëjnë së paku një kundërshtim me një nga dispozitat e kësaj rregulloreje.

Për at kohë sa ankesa konsiderohet e bazuar, komisioni mund të marrë vendimet e mëposhtme:

a) Ai mund t'i japë çdo lloj rekomandimi që gjykon të dobishme, në raport me zbatimin e kësaj rregulloreje, drejtorit të Qendrës dhe autoritetit qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

b) Ai mund të anulojë plotësisht apo pjesërisht vendimin për të cilin është bërë ankesa.

c) Ai mund t'i japë autoritetit qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit çdo lloj rekomandimi që e gjykon të arsyeshme në lidhje me sanksionin kundrejt personelit të Qendrës përgjegjës.

3. Kur anulohet vendimi, komisioni informon të huajin e ndaluar, drejtorin e Qendrës dhe autoritetin qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit mbi vendimin e marrë.

4. Drejtori i Qendrës siguron rivendosjen e situatës së të huajit të ndaluar në përputhje me vendimin e komisionit.

Neni 4

1. Rregullat dhe procedura e funksionimit të komisionit të përhershëm përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 5

1. Marrja dhe trajtimi i një ankese nuk pezullon masat për largimin nga territori të të huajit të ndaluar.

Neni 6

1. Qendra përpilon një raport vjetor të veprimtarisë së saj me të dhënat e mëposhtme:

a) Numri total i të huajve të ndaluar sipas shtetësive;

b) Kohëzgjatja e qëndrimit për çdo të huaj të ndaluar;

c) Numri total i arratisjeve/tentativave për arratisje;

d) Numri total i transferimeve drejt institucioneve të tjera;

e) Numri total i largimeve/riatdhësimeve të ndara sipas shtetësive;

f) Numri total i izolimeve, kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në izolim dhe motivet e tij sipas shtetësisë;

g) Kostoja mesatare e jetesës për çdo të huaj të ndaluar;

h) Numri total i tentativave për vetëvrasje;

i) Numri total i grevave të urisë etj.

2. Ky raport i transmetohet autoritetit qendror të Policisë Kufitare dhe Migracionit, i cili informon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe nëpërmjet tij, Ministrin e Brendshëm.

Dispozitë e fundit

Ngarkohet Ministria e Brendshme të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.